



1942/3 Prot

14.07.2023

**RREGULLORE
E BORDIT DREJTUES
TË
SPITALIT RAJONAL SHKODËR**

PËRMBAJTJA

Qëllimi	3
Përbërja e Bordit Drejtues	3
Zëvendesimi i anëtareve të bordit	4
Detyrat e Sekretarit të Bordit	4
Detyrat dhe funksionet e Bordit Drejtues	4
Administratori i përgjithshëm	5
Mbledhjet, Quorumi dhe Vendimet.....	5
Dispozitat e fundit	7

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i Rregullores së Bordit Drejtues është të përcaktojë mënyrën e veprimtarisë së këtij Bordi në zbatim të:

- Ligjit Nr. 55/2022 “ Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”,
- Ligjit Nr.10107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”,
- Ligjit Nr 10138 datë 11.05.2009 “Për shëndetin publik”,
- VKM Nr. 36 datë 27.01.2023 ”Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e spitaleve rajonale, terciare dhe qendrave spitalore rajonale publike”

Neni 2

Përbërja e Bordit Drejtues

Bordi Drejtues i Spitalit Rajonal Shkodër përbëhet nga:

- a) një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë;
- b) një përfaqësues i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor;
- c) një përfaqësues i Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
- d) një përfaqësues i Komisionit Mjekësor të Spitalit Rajonal Shkodër
- e) një përfaqësues i Shoqatës së Pacientëve

Neni 3

1. Secila nga organizatat apo institucionet e përmendura në nenin 2, caktojnë me shkrim përfaqësuesit e tyre në Bord.
2. Periudha e përfaqësimit në Bord për cdo anëtar është 3 vjet.
3. Anëtarët e Bordit kanë të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se dy herë radhazi.

Neni 4

1. Kryetari i Bordit është përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Nënkryetari zgjidhet nga anëtarët e bordit me votim të fshehtë.

Neni 5

Zëvendësimi i Anëtarëve të Bordit

Anëtarët e Bordit mund të zëvendesohen në rast se:

- a) japin dorëheqjen,
- b) humbasin funksionin e tyre në institucionin që përfaqësojnë,
- c) humbasin zotesinë juridike për të vepruar.

Neni 6

Pranë bordit me urdhër të Kryetarit caktohet Sekretari/a e bordit i/e cili kryen këto detyra:

- a) Informon me shkrim anëtarët e bordit për ditën, orën, rendin e ditës dhe i pajis anëtarët me materialet sipas tematikës së mbledhjes,
- b) Përgatit listë-prezencën e pjesëmarrjes në mbledhje,
- c) Zbardh vendimet e marra në mbledhje,
- d) Merr masat për nënshkrimin e vendimeve (sipas rastit tek kryetari/nënkryetari apo tek të gjithë anëtarët),
- e) Mban dhe administron një kopje të dokumentacionit të bordit,
- f) Dokumentacioni i mbledhjeve ruhet pranë arkivës së Spitalit Rajonal Shkodër.

Neni 7

Detyrat dhe funksionet

Detyrat dhe funksionet e Bordit Drejtues të Spitalit Rajonal Shkodër janë:

- a) mbikqyr dhe kontrollon drejtimin e veprimtarisë së Spitalit,
- b) miraton statutin, rregulloren e brendshme, ekonomike, financiare, procedurale, të auditimit dhe të kontrollit, me propozimin e Administratorit të Përgjithshëm të Spitalit,
- c) miraton çdo vit raportin vjetor, bilancin, buxhetin vjetor,
- d) miraton përdorimin e të ardhurave dytësore të Spitalit, sipas prioriteteve të tij,
- e) i propozon për miratim Ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë strukturën organizative të spitalit,
- f) miraton indikatorët e performancës së personelit shëndetësor dhe normat e aktivitetit të shërbimit,
- g) miraton kontratën tip për personelin shëndetësor të spitalit me propozim të Administratorit të Përgjithshëm të Spitalit,
- h) kontrollon zbatimin e normave dhe aktivitetit mjekësor të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë lidhur me shërbimet përkatëse klinike,

- i) miraton tarifat për shërbimet jashtë sistemit të referimit sipas udhëzimeve të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë,
- j) emëron Shëfat e Shërbimeve,
- k) harton dhe miraton rregulloren e Bordit Drejtues.

Neni 8

Administratori i përgjithshëm

1. Administratori i përgjithshëm përzgjidhet nga Bordi Drejtues, sipas një procedure konkurimi.
2. Bordi shpall datat dhe bën publike kriteret e vlerësimit të dosjeve.
3. Bordi organizon procedurën nëpërmjet sekretariatit të tij, i cili bën verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar dhe përputhshmërinë e kriterëve për çdo kandidat.
4. Procedura dhe Kriteret e përzgjedhjes përcaktohen në rregulloren e brendshme të Spitalit Rajonal Shkodër, sipas legjislacioneve në fuqi.
5. Lista e kandidatëve me vlerësimet përkatëse i propozohet Ministrit përgjegjës për shëndetësinë, i cili emëron Administratorin e Përgjithshëm Të Spitalit.
6. Administratori i përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Ministri përgjegjës për shëndetësinë, sipas legjislacionit në fuqi.
7. Drejtuesit ekonomikë dhe teknikë emërohen nga Administratori i Përgjithshëm dhe i bëhen me dije bordit.
8. Detyrat e Administratorit të Përgjithshëm dhe të drejtuesve ekonomikë dhe teknikë përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të spitalit.
- 9.

MBLEDHJET, QUORUMI DHE VENDIMET

Neni 9

- Mbledhjet e Bordit janë të hapura.
- Bordi mund të thërrasë në mbledhjet e tij të gjithë drejtuesit e spitalit dhe/ose specialistë, ekspertë të tjerë jashtë spitalit, për çështje të ndryshme.
- Mbledhja thirret nga kryetari i Bordit dhe njoftohet me shkrim të paktën 7 ditë përpara duke bërë të ditur dhe rendin e ditës.
- Administratori i përgjithshëm ka të drejtë të kërkojë mbledhjen e Bordit, kur gjykon se kërkohen vendime të shpejta që nuk janë në kompetencën e tij.
- Kur mbledhja thirret nga Administratori, kriteri i afatit nuk zbatohet.

Neni 10

1. Mbledhja zhvillohet kur janë të pranishëm 2/3 e anëtarëve, në rast të kundërt mbledhja shtyhet për ditën tjetër, duke përsëritur lajmërimin. Në këtë rast, mjafton 1/2 e anëtarëve.
2. Për mbledhjen e Bordit mbahet procesverbal nga një person i përhershëm i autorizuar nga kryetari, dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët, pjesëmarrës me të drejtë vote.
3. Vendimet e Bordit nënshkruhen nga kryetari dhe pasi janë protokolluar mbahen në arkivën e spitalit, sipas pikes f, neni 6 cituar më lart.
4. Bordi mbledhet jo më pak se 4 herë në vit.

Neni 11

1. Vendimet e Bordit merren me shumicë votash.
2. Çdo anëtar i Bordit ka të drejtën e një vote.
3. Kur votat barazohen, vota e kryetarit është vendimtare.

Neni 12

Nënkryetari i bordit ushtron të drejtat e kryetarit në mungesë të tij.

Neni 13

1. Propozimi për vendimet përgatitet dhe nënshkruhet nga Sektorët apo Shërbimet përkatëse dhe miratohet nga Administratori i Përgjithshëm i Spitalit Rajonal Shkodër.
2. Propozimi duhet të përmbajë materiale sqaruese në lidhje me vendimmarrjen e kërkuar dhe i shoqëruar me të gjithë informacionin teknik dhe financiar të nevojshëm sipas rastit.

Neni 14

- Nga ana e anëtarëve të bordit mund të merren vendime qarkulluese, të cilat do të jenë të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e bordit drejtues.
- Vendimet e tilla qarkulluese do të merren vetëm në rastet kur është e pamundur mbledhja e bordit. Në çdo rast secili vendim do të shoqërohet me propozimin e detajuar sqarues në lidhje me përmbajtjen e tij.

Neni 15

- Anëtarët e pranishëm në mbledhje, nënshkruajnë liste-prezencën për çdo mbledhje.

Neni 16

Dispozitat e fundit

Dispozitat e kësaj rregulloreje mund të ndryshohen ose shfuqizohen vetëm mbi bazën e vendimit të anëtarëve të bordit drejtues si dhe mbi bazën e propozimit të paraqitur nga secili prej anëtarëve të tij.

Kjo rregullore hyn në fuqi në momentin e miratimit nga të gjithë anëtarët e Bordit Drejtues.
e Bordit Drejtues.